

V E N D I M
Nr.48, datë 29.1.1993

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.7652, DATË 23.12.1992 "PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE SHTETËRORE"

Në zbatim të ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ngritjen e komisionit qendror të privatizimit të banesave shtetërore pranë Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, të përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, Ministrisë së Punës, Përkrahjes Sociale, Emigracionit dhe të Përndjekurve Politikë, Ministrisë së Rendit Publik, Ministrisë së Industrisë dhe Bankës së Shtetit Shqiptar. Komisioni kryesohet nga ministri i Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

2. Komisioni qendror i privatizimit të banesave shtetërore ka këto detyra dhe të drejta:

- Merr masa për organizimin e punës për zbatimin e ligjit të privatizimit të banesave në shkallë vendi.

- Kontrollon punën për zbatimin e ligjit të privatizimit të banesave shtetërore.

- Merr të dhëna nga komisionet e rretheve.

- Paraqet për zgjidhje në Këshillin e Ministrave çështje që nuk mund të zgjidhen prej tij.

3. Pranë këshillave të rretheve ngrihen komisionet e privatizimit të banesave shtetërore me këtë përbërje:

- Nënkryetari i këshillit të rrethit - kryetar komisioni.

- Sekretari i bashkisë - sekretar komisioni.

Me anëtarë si vijon:

Përfaqësues nga komunat (në rastet kur ka banesa shtetërore), përfaqësues nga seksioni i ndërtim-komunales i rrethit dhe i bashkisë, nga seksioni i ekonomisë dhe i financës në rrethe e bashki, nga seksioni juridik dhe seksioni i urbanistikës, ndërmarrja komunale banesa, dega e Entit Kombëtar të Banesave, dega e rendit publik, përfaqësues nga gjykata e prokuroria.

4. Komisioni i privatizimit në rreth ka këto të drejta e detyra:

- Organizon punën për zbatimin e ligjit të banesave shtetërore në rrethin përkatës.

- Kontrollon saktësinë e zbatimit të ligjit.

- Siguron të dhënat e mëposhtme:

a) Për banesat që janë në proces gjyqësor.

b) Për qytetarët që kanë marrë truall për ndërtim banese.

c) Për qytetarët që kanë përfituar nga ligji "Për tokën" dhe që kanë marrë leje banimi mbas datës 31.7.1991.

d) Për qytetarët që kanë shkuar me shërbim jashtë shtetit dhe për 6 muaj nga mbarimi i afatit të shërbimit nuk janë kthyer familjarisht në atdhe.

e) Siguron listat për ish të burgosurit, të internuarit, të përndjekurit politikë apo të invalidëve të luftës.

f) Siguron listat e banesave, të përcaktuara nga procesverbalet "Rrezik shembje" deri më 31.12.1992.

g) Siguron listat e qytetarëve që kanë marrë kredi dhe që përfitojnë nga ligji "Për privatizimin e banesave shtetërore".

h) Siguron listat e banesave shtetërore ish-pronë private që nuk privatizohen, si dhe të familjeve që banojnë në to deri në dhjetor 1992, të cilat do të konsiderohen të pastrehë.

5. Komisionet e rretheve brenda datës 10.2.1993 organizojnë punën për ngritjen e grupit të punës për kategorizimin e banesave shtetërore të përbërë nga këto persona:

Shefi i seksionit ndërtim-komunal në rreth - kryetar komisioni.

Dhe anëtarë: nga seksioni komunal në bashki ose komunë, seksioni i urbanistikës, ndërmarrja

komunale banesa.

6. Grupi i punës në bazë të kriterëve të tarifave të caktuara në ligjin e privatizimit të banesave harton ndarjen e banesave shtetërore në kategorinë e parë, të dytë dhe të tretë dhe të veçantë, të cilat miratohen nga Këshilli i Rregullimit të Territorit të Rrethit, brenda datës 15.2.1993.

7. Grupi i punës i propozon komisionit të rrethit, brenda datës 15.2.1993 banesat e veçanta që nuk mund të privatizohen, të shoqëruara me një relacion përkatës dhe një planimetri të tyre.

8. Komisionet e rretheve i paraqesin komisionit qendror brenda datës 20.2.1993 këto materiale, i cili pasi i studion ia paraqet Këshillit të Ministrave për miratim.

Këshillat e komunave, të bashkive ose të rretheve, pavarësisht nga propozimet e bëra të komisionit të rrethit, propozojnë pranë komisionit qendror të privatizimit të banesave shtetërore banesat e veçanta që nuk mund të privatizohen brenda të njëjtit afat.

9. Komisionet e rretheve, brenda datës 20.2.1993, organizojnë ngritjen e grupeve të punës pranë ndërmarrjeve komunale të banesave, të cilat do të kryejnë veprime përkatëse me qiramarrësit që dëshirojnë të bëhen pronarë të banesave të tyre, sipas ligjit të privatizimit të banesave shtetërore.

10. Nga veprimtaria e mirëmbajtjes së banesave shtetërore të ndërmarrjes komunale të banesave krijohen sektorët e privatizimit të banesave shtetërore. Këto ndërmarrje të marrin masa për plotësimin me personelin e nevojshëm për kryerjen në afatin e parashikuar në ligj të privatizimit të banesave. Pas përfundimit të procesit të privatizimit, këta sektorë kalojnë në vartësi të Entit Kombëtar të Banësive në Rrethe.

11. Qiratë e banesave shtetërore pas datës 31.12.1993 do të derdhen në llogarinë e Entit të Banësive.

12. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë të marrë masat e duhura për kryerjen e veprimeve përkatëse të hipotekimit të banesave.

13. Ministria e Punës, Emigracionit dhe të Përndjekurve Politikë të hartojë dhe t'i dorëzojë komisioneve të privatizimit të rretheve dhe bashkive listat e personave që përfitojnë statusin e të burgosurit, internuarit e të përndjekurit politik dhe të invalidëve të luftës.

14. Ngarkohen degët e Bankës Kombëtare në rrethe të hartojnë dhe të dorëzojnë pranë Entit Kombëtar të Banësive listat e qytetarëve që kanë marrë kredi me vlefat përkatëse, që përfitojnë nga neni 15 i ligjit "Për privatizimin e banesave shtetërore".

15. Në mbështetje të nenit 16 të ligjit "Për privatizimin e banesave shtetërore", pranë çdo bashkie ose komune ngrihet një komision i veçantë, i cili cakton qytetarët e banesave private që do të përfitojnë nga ky ligj.

Për efekt llogaritjeje do të merret parasysh gjendja aktuale e strehimit të tyre, pavarësisht nga bashkëpronarët.

16. Në mbështetje të nenit 6 të ligjit "Për privatizimin e banesave shtetërore", kësti minimal do të jetë 250 lekë në muaj. Në të ardhmen ky këst do të indeksitet sipas nivelit të rritjes së pagave.

17. Derdhja e tarifave nga qytetarët për blerjen e banesave do të bëhet në një llogari të veçantë të Entit të Banësive që do të hapet për këtë qëllim.

18. Për të gjitha problemet që do të lindin në zbatim të ligjit të privatizimit të banesave shtetërore, do të veprohet sipas udhëzimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

19. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës, Emigracionit dhe të Përndjekurve Politikë, Ministria e Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike, Ministria e Rendit Publik, Banka Kombëtare dhe këshillat e rretheve, bashkitë e komunat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi